

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 1005 Prot.

Kuçovë, më 04.03 2026

V E N D I M

Nr. 17, datë 15/02 2026

Për

“Miratimi i Dhënies së Ndhmës Financiare për familjen e përmytur nga reshjet e shumta të datës 07.01.2026, Për Përballimin E Dëmeve Të Shkaktuara Nga Fatkeqësi Natyrore”.

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, mbështetur në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim të V.K.M nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, referuar dhe shkresës me nr.64/2 Prot. datë 09.02.2026 nga Këshilli i Qarkut Berat, protokolluar në institucionin tonë me nr. 82/1 Prot. datë 10.02.2026.

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të emergjencës sipas preventivit të hartuar nga Këshilli i Qarkut Berat për familjen e Znj. Adriana Salaj, ku sipas preventivit të vlerësimit të dëmeve për banesën e Znj.Adriana Salaj është vlerësuar me shumën 413,610 lekë, në zbatim të ligjit të sipërpërmendur do të dëmshpërblehen me 50% të shumës së preventivit, ku shuma përfituese është 206,805 lekë.
2. Ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua me 18 vota Pro, 1 vota kundër dhe 1 vota abstenim.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU

